



## TERMA REFERENCE

THIRRJE PER TRAJNER / EKSPERT

MJEDISOR / EKOLOG

në kuadër të projektit:

**“MBROJTJA E BIODIVERSITETIT NËPËRMJET RRITJES SË NDËRGJEGJËSIMIT DHE KAPACITETEVE TË  
GAZETARËVE”**

## PËRMBAJTJA

### INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Autoriteti i kontraktuar
- 1.2 Rreth organizatës
- 1.3 Rreth projektit
  
2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET SPECIFIKE
  - 2.1 Objektivat dhe rezultatet e përgjithshme
  - 2.2 Zona gjeografike
  - 2.3 Puna specifike
  
3. MENAXHIMI I PROJEKTIT
  - 3.1 Organi përgjegjës
  - 3.2 Struktura e menaxhimit
  
4. LOGJISTIKA DHE KOHA
  - 4.1 Vendndodhja
  - 4.2 Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave
  
5. KERKESAT
  - 5.1 Kriteret specifike për Trajnerin

## 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

### 1.1 Autoriteti i Kontraktuar

Shoqata “Together for Life” Rr. Brigada e VIII-të, Pallati Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania.

### 1.2 Rreth organizatës

Shoqata “Together for Life” është një organizatë jofitimprurëse, e themeluar më 24 dhjetor 2009. Misioni i “Together for Life” është promovimi dhe mbroja e të drejtave të njerëzve në nevojë, mbështetja familjeve dhe komuniteteve të marginalizuara me qëllim integrimin e tyre në jetën ekonomiko-sociale të vendit; mbrojtja e jetës dhe natyrës. Programet e “Together for Life” fokusohen në fushën e shëndetësisë, barazisë gjinore, çështjet mjedisore, turizmit, transparencës dhe llogaridhënies. “Together for Life” kryen një sërë aktivitetesh që lidhen kryesisht me informimin dhe edukimin, fushatat publike sensibilizuese, investigime, kërkime dhe shkrimin e raporteve studimore.

### 1.3. Rreth Projektit

Projekti që do të implementohet nga Shoqata “Together for Life” synon të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit për kërcënimet ndaj biodiversitetit dhe nevojën për mbrojtjen e tij bazuar në informimin cilësor të gazetarëve që trajtojnë çështje mjedisore. Rritja e njohurive dhe forcimi i kapaciteteve të gazetarëve rreth çështjeve të ndjeshme mjedisore ndikojnë në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në përgjithësi dhe komuniteteve të veçantë, në raste specifike, rreth nevojës për pjesëmarrje në vendimmarrje në çështje që prekin ambientin që na rrethon.

Ndryshimet mjedisore ndikojnë në ndryshimin e komuniteteve të botës bimore dhe shtazore të habitate të caktuara dhe kur këto ndryshime përkeqësojnë këto habitate, ndikojnë edhe në ndryshime të sotme dhe të ardhme që ndikojnë tek cilësia dhe siguria e jetës së njerëzve në vende ku kanë ndodhur këto ndryshime dhe pranë tyre.

Media është një mjet edukativ për publikun dhe ruajtja e biodiversitetit është një çështje e ndërgjegjësimit të publikut. Përfshirja e medias dhe rritja e kapaciteteve të saj është qasja e duhur për të përmirësuar mbulimin mediatik të biodiversitetit dhe çështjeve mjedisore.

Projekti ofron trajnim tre-ditor për gazetarët / editorët e medias kombëtare dhe lokale të qarkut të Gjirokastrës për çështjet mjedisore. Trajnimi do të zhvillohet në qarkun e Përmetit, ku një ditë do t'i kushtohet vizitës përgjatë rrjedhës së lumit Vjosa, konsideruar si lumi i fundit i egër në Evropë, dhe në masivin pyjor Bredhi i Hotovë-Dangëllisë, për t'u dhënë mundësinë gazetarëve që të mësojnë më shumë rreth natyrës edhe duke e “prekur” atë.

Dhjetë gazetarët e trajnuar do të krijojnë një rrjet informal profesionistësh të pajisur me njohuri të konsoliduara rreth çështjeve mjedisore të cilët marrin përsipër të informojnë cilësisht dhe në kohë publikun / komunitetin nëpërmjet publikimeve dhe transmetimeve të lajmeve që kanë në fokus ruajtjen e natyrës. Gazetarët e trajnuar do të inkurajohen të publikojnë lajme / shkrime për Parkun Kombëtar Hotovë-Dangëlli dhe lumin e Vjosës. Shkrimet dhe informacionet do të publikohen në një faqe fansash që do të krijohet në FB.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET

### 2.1 Objektivat dhe rezultatet e përgjithshme të Projektit

- Objektivi kryesor i projektit është të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit për kërcënimet ndaj biodiversitetit dhe zgjidhjeve të bazuara në ruajtje duke përfshirë lajme dhe informacion cilësor.
- Objektivi specifik i projektit është forcimi i kapaciteteve të gazetarëve shqiptarë të mediave kombëtare/vendore dhe organizatave mediatike për çështjet e biodiversitetit dhe ruajtjes; dhe rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e biodiversitetit dhe ruajtjes dhe ndikimin e tij në jetën e ardhshme të planetit përmes mbështetjes së rrjetit të gazetarisë

## 2. DETYRAT SPECIFIKE TË TRAJNERIT

### 2.1 Trajneri do të jetë përgjegjës për:

- Përgatitjen e një moduli trajnimi në formatin PPT, me informacione rreth mjedisit dhe nevojës për marrjen e masave për mbrojtjen e natyrës.
- Rritja e njohurive dhe kapaciteteve të 10 gazetarëve dhe/ose redaktorëve;
- Nxitja e debateve / diskutimeve tek pjesëmarrësit nëpërmjet planifikimit dhe realizimit të seancave të diskutimeve, role-play, punë në grupe, për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
- Në bashkëpunim me stafin e projektit dhe trajnerët e tjerë do të konceptojë draft-agjendën e trajnimit;

- Të realizojë seancën e trajnimit në përputhje me agjendën e aktivitetit, objektivat dhe rezultatet e dakorduara me stafin e projektit si dhe në përputhje me standardet dhe etikën profesionale.

## 2.2 Afatet

Në afatet e vendosura nga stafi i projektit, por gjithmonë jo më vonë se 10 ditë nga realizimi i trajnimit, eksperti/ trajneri do të dorëzojë pranë stafit të projektit dokumentet e mëposhtme:

- Moduli i trajnimit (në word dhe/ ose në PPT) si dhe informacionet e tjera të përdorura gjatë trajnimit);
- Raport rreth impaktit të trajnimit tek pjesëmarrësit.

## 2.3 Angazhimi konkret sipas afateve kohore

Përshkrimi i aktivitetit	Vendi	Data/afatet	Ditë pune
Përgatitja e modulit të trajnimit	Zyrë / Tiranë	Mars-prill 2022	4 ditë
Trajnim	Përmet	Prill 2022	2 ditë
Numri total i ditëve është			6 ditë

## 3. MENAXHIMI I PROJEKTIT

### 3.1 Organi përgjegjës

Shoqata “Together for Life” Rr. Brigada e VIII-të, Pll. Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania

### 3.2 Struktura përgjegjëse

Projekti zbatohet nga Shoqata “Together for Life”. Kjo shoqatë është përgjegjëse për prokurimin dhe implementimin e çdo aktiviteti.

### 3.3 Lehtësirat nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti kontraktor do i japë kontraktuesit menjëherë çdo informacion dhe/ose dokumentacion të dobishëm që mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e kontratës.

## 4 LOGJISTIKA DHE KOHA

### 4.1 Vendndodhja

Tiranë, zyra e TLF; Përmet.

### 4.2 Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave

Trajneri fillon angazhimin në kuadër të projektit në fillim të muajit prill dhe kontrata përfundon 10 ditë pas përfundimit të trajnimit, por gjithmonë jo më larg se 30 prill 2022.

## 5 KËRKESAT

### 5.1 Kriteret specifike për trajnerit/es

Personat e interesuar për pozicionin e trajnerit/es duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të ketë diplomë në shkencat e natyrës, agrare ose ambientaliste;
- Të ketë eksperience të mëparshme në fushën e trajnimit me të rritur në fushën e mjedisit;
- Të ketë bashkëpunime të mëparshme me shoqërinë civile në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe/ose tema të lidhura me të;
- Të ketë komunikim shumë të mirë, të dëgjojë dhe respektojë mendimin e secilit prej personave të përfshirë në trajnim dhe në projekt;
- Të ketë aftësi të mira pedagogjike të nxënies interaktive.

Kandidati duhet të paraqesë nëpërmjet emailit ose në zyrat e TFL (në adresat e mëposhtme):

- CV personale;
- Letër motivimi

Shoqata "Together for Life", Rr. Brigada e VIII-të, Pll. Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania

Posta elektronike: [info@togetherforlife.org.al](mailto:info@togetherforlife.org.al)

Afati përfundimtar për aplikim është data 31 mars 2022, ora 17:00.